

Termet e Referencës

“Trajnim rreth Auditimit Social për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre”

I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983.

Si organizatë përfaqëson, përkrah dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barazinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara

II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Advancing Rights and Participation of Children with Disabilities in Kosovo”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA).Projekti përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të monitoruar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje në nivel lokal.

III. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS është duke organizuar një trajnim dyditor me fëmijët me aftësi të kufizuara (mosha 11-18 vjeç) dhe një sesion informues me prindërit e tyre, lidhur me konceptin dhe praktikën e auditimit social. Ky aktivitet synon t’i njohë pjesëmarrësit me rolin e tyre në monitorimin e projekteve publike dhe në kërkimin e llogaridhënies nga institucionet.

Përmes këtij procesi, fëmijët dhe prindërit do të kuptojnë se si mund të përfshihen në mënyrë aktive në vlerësimin e shërbimeve dhe investimeve publike që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre. Aktiviteti zhvillohet në kuadër të qasjes së auditimit social, duke vendosur fëmijët në qendër të procesit si kontribues aktivë në identifikimin e problemeve dhe në formulimin e rekomandimeve.

Përmes këtij aktiviteti, synohet:

- Të rritet kuptimi i fëmijëve dhe prindërve për auditimin social si proces i llogaridhënies.
- Të sigurohet përfshirja kuptimplote e fëmijëve në përzgjedhjen e projekteve për auditim.
- Të krijohen njohuritë dhe kapacitetet fillestare për zbatimin e një procesi të auditimit social.
- Të mbështetet përzgjedhja e një projekti publik që mund të jetë subjekt i auditimit social në fazat e mëtejshme të projektit.

IV. KUALIFIKIMI

Eksperti/ja i/e angazhuar për realizimin e këtij aktiviteti duhet të plotësojë këto kriteret:

- Të ketë diplomë universitare në fusha relevante si shkenca sociale, të drejtat e njeriut ose fusha të ngjashme.
- Të ketë përvojë në facilitimin e trajnimeve dhe proceseve pjesëmarrëse, veçanërisht me grupe të marginalizuara.
- Të ketë njohuri dhe përvojë praktike në auditim social, monitorim qytetar, avokim ose llogaridhënie publike.
- Të ketë aftësi për të hartuar materiale të thjeshta dhe të kuptueshme për pjesëmarrësit.

Preferohet që eksperti/ja:

- Të ketë njohuri mbi kornizën ligjore dhe institucionale në Kosovë lidhur me shërbimet publike dhe pjesëmarrjen qytetare.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës për planifikimin, facilitimin dhe mbështetjen metodologjike të procesit të auditimit social.

Në mënyrë më specifike, eksperti/ja do të:

- Hartojë agjendën, metodologjinë dhe materialet e trajnimit, në përputhje me parimet e auditimit social dhe qasjen gjithëpërfshirëse.
- Facilitojë trajnimin dyditor me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sesionin informues me prindërit e tyre, duke përdorur metoda interaktive dhe të përshtatura për moshën dhe nevojat e pjesëmarrësve.
- Prezantojë konceptet bazë të auditimit social dhe të mbështesë pjesëmarrësit në kuptimin e rolit të tyre në monitorimin e projekteve dhe shërbimeve publike.
- Lehtësojë një proces konsultues me fëmijët dhe prindërit për identifikimin dhe përzgjedhjen fillestare të një projekti publik që mund të jetë subjekt i auditimit social në fazat e mëvonshme të projektit.
- Ofron udhëzime praktike dhe orientuese për metodat e mbledhjes së të dhënave që mund të përdoren në kuadër të një procesi të auditimit social.
- Përgatisë materiale dhe mjete të thjeshta mbështetëse që do t'u shërbejnë pjesëmarrësve gjatë fazave të ardhshme të procesit.
- Hartojë raportin e aktivitetit dhe të dorëzojë materialet e zhvilluara gjatë angazhimit.
- Koordinojë ngushtë me stafin e HANDIKOS për organizimin dhe realizimin e aktivitetit.

VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Qershor 2026 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Përgatitja e metodologjisë, agjendës dhe materialeve të trajnimit	1ditë
Fasilitimi i trajnimit	2 ditë
Hartimi i raportit të trajnimit	1 ditë
Përmbledhja e procesit dhe përgatitja e materialeve mbështetëse	3 ditë
TOTALI	7 ditë

VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa do të bëhet pas përfundimit të aktivitetit dhe dorëzimit të raportit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizojë pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim;
- Curriculum Vitae (CV);
- Propozimi financiar.

Aplikimet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: nora.simitciu@handi-kos.org.
Ju lutem, shkruani në subjekt Trajnimi rreth Auditimit Social.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është 15 Qershor.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve** si dhe **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.